

EPPC Albania kërkon një **Drejtor Fabrike**, për një kompani shqiptare e cila operon në sektorin e prodhimit të tubave dhe rakordimeve plastike dhe hidraulike.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Mbikqyr operacionet ditore duke përfshirë procesin e prodhimit si dhe shpërndarjen e forcës punëtore për të përmbushur në kohë, me cilësi dhe kosto efektive prodhimin sipas kërkesave të klientëve;
- Planifikon dhe organizon punën dhe proceset në fabrikë;
- Vlerëson dhe analizon kostot;
- Mbikqyr, drejton, motivon dhe vlerëson performancën e stafit;
- Përgjegjës për funksionimin dhe mirëmbajtjen e makinerive;
- Siguron ndjekjen e udhëzimeve të shëndetit, mjedisit dhe sigurisë;
- Mban marrëdhënie direkte me klientë brenda dhe jashtë vendit;
- Mban marrëdhëniet me entet publike dhe organet shtetërore;
- Përgatit dhe menaxhon buxhetin e fabrikës, monitoron shpenzimet dhe kostot e investimeve;
- Zhvillon dhe ruan treguesit kryesore të performancës (KPI) për të monitoruar performancën e prodhimit dhe raportuar atë tek Administratori i kompanisë.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare në **Administrim Biznes** ose në **degët Inxhinierike**;
- **Përvojë e mëparshme pune në pozicione të ngjashme drejtuese në kompani prodhimi; (Domosdoshmëri)**
- Aftësi drejtuese, vendimmarrëse dhe problem-zgjidhëse;
- **Njohuri shumë të mira të gjuhës Angleze dhe Italiane;**
- Njohuri shumë të mira të paketës MS Office.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni aplikimin tuaj duke ndjekur linkun e mëposhtëm:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.